

**ERARBA ÇIRAKU**

Qendra e Botimeve Enciklopedike / Akademia e Studimeve  
Albanologjike, Tiranë  
erarba\_ciraku@yahoo.com

**DOKUMENTE DIPLOMATIKE ITALIANE**  
**MBI ISMAIL QEMALIN**  
**(17 gusht 1908-21 korrik 1910)**

**1.**

**Raport i ambasadorit italian në Londër, drejtuar ministrit të  
Jashtëm rreth programit të Ismail Qemalit mbi Shqipërinë**

Ambasada e Mbretërisë së Italisë në Londër

*Londër, 17 gusht 1908*

*Lënda:* Italia dhe Shqipëria. Një bisedë tjetër me Ismail Bej Qemalin.

Zoti Ministër,

Në raportin tim nr. 454 të këtij muaji ju kam informuar mbi një takim timin me Ismail Bej Qemalin.

Por, duke qenë se atë mbrëmje nuk ishim vetëm, ai kërkoi pardje një takim kokë më kokë me mua.

Ai shumë shpejt do të vijë në Itali, ku shpreson të takohet me Shkëlqesinë Tuaj dhe me komandator<sup>1</sup> Bollati-n<sup>2</sup>. Cilido qoftë niveli i besimit që ai meriton, programi që më parashtroi ia vlen të merret në konsideratë. Qoftë edhe me ndonjë sakrificë financiare, ne mundemi të lehtësojmë zbatimin e pjesshëm të tij dhe të marrim një rezultat politik të çmueshëm.

---

<sup>1</sup> Titull kalorësiak.

<sup>2</sup> *Riccardo Bollati* (1958-1939) - Diplomati dhe burrë shteti i ish-Mbretërisë së Italisë. Më 1891 në Bukuresht ka marrë fillësë një eksperiencë e gjatë diplomatike e tij në Ballkan, duke u bërë një nga specialistët më në zë të çështjeve ballkanike të diplomacisë italiane. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme për periudhën qershor 1907-1912.

Në fakt, ne na leverdis gjithçka që mund të kontribuojë në formimin e një kombi shqiptar të ndërgjegjshëm, të fortë e të aftë për t'u bërë barrikadë ndaj ambicieve të palëve të tjera; si dhe gjithçka që do të mund të zhvillojë resurset ekonomike të këtij rajoni dhe do të na lejojë të marrim pjesë në ngritjen e vlerës së tij.

Vështirësitë janë të mëdha, pavarësisht optimizmit të Ismail Bej Qemalit. Por, disa rezultate ekonomike dhe politike mbase edhe mund të arrihen nëse do të dihet të përfitohet pa vonesë nga periudha e tanishme e liberalizmit, optimizmit dhe vëllazërisë mes kombësive e besimeve të ndryshme që ndoshta nuk do të zgjasë edhe për shumë kohë.

Programi i Ismail Bej Qemalit është si vijon:

*“Kushtetuta, - shprehet ai, - e hartuar përpara luftës turko-ruse, në kushte të ndryshme nga të tanishmet, nuk mund të mjaftojë për të përmbushur të gjitha ndjenjat dhe nevojat e kombeve të ndryshme në Perandori. Nevojitet që duke ruajtur integritetin, ato të kenë një autonomi të gjerë administrative. Mundet edhe të ndahet Shqipëria në një dy, tre apo katër vilajete, por duhet që këto të përfshijnë të gjitha rajonet gjeografikisht dhe etnikisht shqiptare, mes të cilave edhe zonat që bëjnë pjesë në vilajetet e Kosovës dhe Manastirit, të cilat duhet të shkëputen.*

*“Nëse Italia, - vë në dukje Ismail Qemali, - do të bashkëpunojë në këtë drejtim, do t'u sjellë dobi interesave të saj, si për sa i përket rritjes së ndikimit të saj në Shqipëri ashtu edhe në lidhje me krijimin e një mburoje të fortë etnike kundër ambicieve të tjetërkujt. Por kjo nuk mjafton”.*

*“Nevojitet, - thotë Ismail Qemali, - që të hapen sa më parë një numër sa më i madh shkollash shqipe dhe të shtypen e shpërndahen libra shqip. Me të bërë këtë reformë të madhe, tepër efikase për zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare, askush nuk do të mund ta revokojë më; edhe nëse Kushtetuta do të dështonte, edhe në rast se Abdülhamiti që i është kundërvënë gjithnjë, do të rimerrte fuqinë e mëparshme absolute me po të njëjtin shpirt reaksionar”.*

Për mbulimin e shpenzimeve të shtypjes dhe shpërndarjes së librave shqip dhe për shkollat normale, nevojitet një shumë prej rreth 150 mijë lirash italiane që Italia duhet t'i japë fshehtazi, menjëherë e pa humbur kohë. Më tej, kjo shumë do të nxirret nga zbatimi i pjesës së tretë të programit të Ismailit: *Penetrimi ekonomik italian në Shqipëri.*

Nëse kapitalistët italianë do të shpejtojnë, Ismaili beson se tani që ai dhe miqtë e tij janë në pushtet në Kostandinopojë apo në Shqipëri ose të paktën në Shqipërinë toske, iniciativat italiane nuk do të përballen më me

pengesa sikundër ka ndodhur në të kaluarën, por do të kenë të gjitha lehtësitë. Do të mund të shfrytëzohen minierat, të priten pyjet për të bërë trase, të ndërtohen rrugë, industri, të themelohen një apo më shumë shoqëri. Me një pjesë të fitimeve të këtyre sipërmarrjeve do të mund të subvencionohet mësimi i gjuhës shqipe që për momentin duhet të bëhet në mënyrë të fshehtë nga qeveria italiane, sikurse u tha më lart apo nga Shoqata “Dante Alighieri”, ose nga ndonjë institut financiar italian që ka marrëdhënie me qeverinë e Mbretit. Ndër sipërmarrjet e ndryshme, ajo që Ismaili rekomandon më së tepërmi, është ndërtimi i hekurudhës Vlorë-Manastir, për të cilën sipas mendimit të tij do të ishte e mundur të studiohej një gjurmë më ekonomike dhe shpërblyese nga ajo që është paraqitur në projektet e ndryshme, të cilat prej vitesh flenë në sirtar.

Zhvillimi ekonomik i Shqipërisë do të favorizojë edhe vendosjen e një mënyre jetese më të qytetëruar dhe të rregullt. Edhe shqiptarët më të trazuar, gegët, do ta vlerësojnë rendin dhe ligjshmërinë kur të fillojnë t'i perceptojnë si dy kushte thelbësore të mirëqenies ekonomike. Deri më tani anarkia dhe dhuna kanë qenë dhe vijojnë të jenë mjete të domosdoshme jetese në pjesën më të madhe të rajoneve geqe.

Ky ishte programi i Ismail Qemalit.

Në vijim po parashtroj mendimet e mia:

Vështirësitë e aktualizimit të tij nuk janë as të pakta e as të lehta. Edhe nëse do të abstragojmë nga ndërhyrja e mundshme e Fuqive të tjera, vështirë që xhonturqit të lejojnë shkëputjen e territoreve shqiptare nga Maqedonia, të cilat për Turqinë përbëjnë një kundërpeshë ndaj elementit sllav, e sidomos atij bullgar. Nuk ka gjasa që Italia të ndërmarrë ndonjë hap në këtë drejtim pa ngjallur dyshime, duke shkaktuar kështu efektin e kundërt. Ismaili beson se xhonturqit do ta kuptojnë se për Perandorinë është më mirë të kenë mbështetjen e të gjithë kombit shqiptar, sesa një kundërpeshë lokale. Kam dyshim se optimizmi i tij është i pajustificuar. Kurdoherë që do të lejohej shkëputja - duke qenë se shqiptarët, serbët dhe bullgarët nuk do të jenë dakord në përcaktimin e kufijve - do të rindizen kontestimet reciproke, dhe varësia ekonomike e zonave malore shqiptare nga fushat e Kosovës dhe Manastirit do ta komplikonin më tepër situatën. Nuk ka dyshim ama se kjo shkëputje, të paktën për sa i përket sanxhakut të Elbasanit, do të ishte në përputhje me interesat e Italisë.

Më duket edhe më e vështirë që xhonturqit të miratojnë programin e autonome kombëtare. Ato kanë precedentë te sistemi ekzistent i

mileteve, në projektet ruse para luftës së Krimesë, në vetë vijën politike të Muhametit II, por më ngjan se bie ndesh me synimet dhe me programin e Iyer me ngjyrë franceze të turqve që janë sot në pushtet.

Në vend të kësaj, më duket se qeveria liberale osmane nuk mundet në këtë moment të refuzojë shkollat shqipe, dhe as lejen për të shtypur e shpërndarë libra shqip, me kusht që të mos jenë subversivë. Po u vu në zbatim një gjë e tillë, askush nuk mund të ketë fuqi që ta revokojë, edhe në rast se kthehet regjimi hamidian; do të ishte një rezultat me rëndësi dhe efikasitet të madh për të ardhmen e kombit shqiptar. Është padyshim në interes të Italisë që ky rezultat të arrihet, edhe nëse do të duhet të sakrifikojë një shumë prej 150 mijë lirash a më shumë bazuar te llogaritjet e bëra nga Ismaili. Mungojnë mësues të mirë, por pak rëndësi ka kjo; mjafton që qeveritarët e ardhshëm të Turqisë qofshin këta edhe despotë të ndodhen përpara faktit të kryer, pra, e drejta e njohur dhe e zbatuar e mësimit dhe shtypjes në gjuhën shqipe, dhe me shumë shkolla të hapura në lokalitete të ndryshme, pasi nuk mundet të ringjallet rishtazi koncepti i Abdülhamitit i cili për të mos thyer unitetin e Islamit nuk dëshironte që në gjirin e kësaj vëllazërie të madhe fetare të lindte fara e ndërgjegjes kombëtare.

Gjykoj se penetrimi ekonomik në shkallë të gjerë paraqet vështirësi shumë herë më të mëdha nga sa thotë Ismaili, por me siguri mund të bëhet diçka në rajonin që ka si kryeqendër Vlorën, ku familja Vlora dhe të afërm e miq të Ismailit kanë prona dhe ndikim. Hekurudha Vlorë-Manastir është më me interes për ne sesa ajo Stimlia-Shkodër-Shëngjin. Por edhe kjo linjë hekurudhore na intereson, dhe nëse për këtë linjë kapitalet dhe lidhjet e nevojshme janë siguruar, për linjën tjetër hekurudhore ende jo. Gjykoj se nuk duhet sakrifikuar e mira me shpresën se do të kemi edhe më mirë. Me fjalë të tjera, mes hekurudhës së Shëngjinit dhe asaj të Vlorës, Italia, sipas mendimit tim, duhet t'i japë përparësi asaj që paraqet mundësitë më të mëdha për t'u ndërtuar. Pranoni, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

**SANGIULIANO**

## 2.

**Raport i konsullatës italiane në Janinë për ministrin e Punëve të Jashtme, mbi takimin e regjentit të nënkonsullatës italiane në Vlorë me Ismail Qemalin**

Konsullata e Përgjithshme e Madhërisë së Tij, Mbretit të Italisë

*Janinë, 25 shtator 1908*

Nr. 1075/210

Zoti Ministër,

Më datë 18 të këtij muaji, duke ardhur nga Londra dhe Roma përmes Korfuzit, ka zbarkuar në Vlorë i njohuri Ismail Qemal Bej Vlora, i cili u prit me entuziazëm të madh nga popullata.

Teksa më raportonte detajet e pritjes patriotike që shqiptarët i bënë këtij mërgimtari, zoti regjent i nënkonsullatës në Vlorë shton si vijon:

“Të nesërmen e mbërritjes së Ismail Bej Qemalit e gjykova me vend të shkoja ta takoja dhe t’i uroja mirëseardhjen. U prita me dashamirësi të sinqertë dhe kur u mor vesh që isha italian dhe i punësuar në konsullatë, ai më bëri shumë e shumë deklarata në favor të vendit tonë dhe më tha se interesi i Shqipërisë është që të jetë gjithnjë mike besnike e Italisë dhe ta konsiderojë atë si mbrojtëse të saj. Më tej, më rrëfeu se sipas marrëveshjes me mikun e tij Sanguiliano kishte kaluar në Romë për të takuar Shkëlqesinë e Tij ministrin Tittoni,<sup>3</sup> por në mungesë të tij qe pritur nga Shkëlqesia e Tij nënsekretari i Shtetit i nderuari Pompili dhe kishin rënë dakord që të themelonin shoqëri me kapital italian për ndërtimin e hekurudhave si dhe për sipërmarrje të tjera në Shqipëri.”

<sup>3</sup> *Tommaso Tittoni* (1855-1931) - Ministër i Punëve të Jashtme të Italisë 1903-1905; 1906-1909.

Për një periudhë të shkurtër, vetëm 12 ditë (16 mars-28 mars 1905), ka mbajtur postin e Presidentit të Këshillit të Ministrave. Ministër i Punëve të Brendshme (mars-dhjetor 1905). Ambasador i Italisë në Londër (shkurt-maj 1906). Në vitin 1906, emërohet rishtazi ministër i Punëve të Jashtme në qeverinë e Giolitti-t. Në pozitat e ministrit të Punëve të Jashtme, më 1908, është përballur me situatën e vështirë të krijuar si rrjedhojë e krizës boshnjake, e cila rrezikoi edhe vetë ekzistencën e Aleancës së Trefishtë, ku Austro-Hungaria refuzonte t’i njihte Italisë kompensimet territoriale të dakordësuara më 1891, në rastin e një ekspansioni austriak në Ballkan. Ka mbuluar detyrën e ambasadorit të Mbretërisë në Paris nga prilli i vitit 1910 deri në nëntor të vitit 1916.

Për sa më sipër kam raportuar në ambasadën mbretërore në Cospoli.

Me nderim

[Firma]

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8242-8243

### 3.

#### **Informacion i ministrit të Punëve të Jashtme, drejtuar konsullit të Përgjithshëm italian në Janinë, mbi takimin e Ismail Qemalit me nënsekretarin italian të Shtetit**

Ministria Mbretërore e Punëve të Jashtme

*Romë, 8 tetor 1908*

Zoti konsull i Përgjithshëm,

Ju informoj për marrjen e raportit nr. 1075/210, të datës 25 shtator, në të cilin Zotëria Juaj më përcillte informacionin e marrë nga regjenti i nënkonsullatës në Vlorë mbi kthimin atje të Ismail Qemalit dhe mbi bisedën e tij me agjentin mbretëror.

Për dijenin tuaj, ju informoj se Ismail Bej Qemali ka kaluar disa javë në Romë dhe u prit nga nënsekretari i Shtetit që u rezervua ta dëgjojë duke i shprehur se, nëse dëshironte të bënte propozime apo kërkesa efektive të çfarëdolloj natyre, do të duhej të bisedonte direkt me ministrin.

Ismail Bej Qemali është përgjigjur se, duke qenë se nuk ishte rrugë e gjatë do të rikthehej me dëshirë në Romë për këtë qëllim.

Gjatë takimit, ndër të tjera, nga ana e Ismail Bej Qemalit u përmend mundësia për përhapjen e gjuhës dhe të shkollave shqipe; i është dhënë përgjigje se në përgjithësi kjo gjë është e pranueshme, por nuk është bërë fjalë as për kapital italian e as për sipërmarrje të tilla.

Ju lutem, të vini në dijeni për këtë regjentin e nënkonsullatës së Vlorës.

**TITTONI**

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8244-8245

#### 4.

**Raport i ambasadorit italian në Stamboll drejtuar ministrit të  
Jashtëm, në lidhje me projektin e Ismail Qemalit për zgjim kombëtar  
dhe rimëkëmbje ekonomike të Shqipërisë për zbatimin e të cilit  
kërkohet mbështetja e Italisë**

*Terapia, 30 tetor 1908*

Nr. 2528/798

Drejtuar Shkëlqesisë së Tij senatorit Tittoni, ministër i Punëve të Jashtme  
Italia dhe Shqipëria; projektet e Ismail Bej Qemalit.

Zoti Ministër,

I referohem korrespondencës së Shkëlqesisë Suaj më datë 13 shtator,  
numër 53396/773, pozic. 17.

I bashkohem plotësisht mendimit të markezit di Sangiuliano në  
lidhje me vështirësitë e karakterit politik që paraqet zbatimi i programit të  
Ismail Bej Qemalit në territoret e racës shqiptare.

Ndërsa, për sa i përket interesit që mund të ketë Italia për të  
bashkëpunuar pa hezitim në hapjen e shkollave kombëtare në Shqipëri  
dhe në shpërndarjen e librave në gjuhën shqipe qoftë duke bërë edhe një  
sakrificë monetare, vë në dukje si më poshtë:

1. Përpara se të merret një vendim rreth madhësisë së subvencionit  
që do të akordohet, duhet pritur mbledhja e Parlamentit, për të  
ditur se në cilat kushte do të autorizohet mësimi në gjuhën shqipe,  
dhe nëse kjo do të jetë e kufizuar vetëm në shkollat fillore apo do  
të lejohet edhe në shkollat e nivelit të dytë ndryshe nga sa  
mendojnë xhonturqit;
2. Do të duhet që investimi i qeverisë mbretërore për rilindjen  
shqiptare të ketë të njëjtin avantazh edhe për Italinë, dhe që  
mbështetja e saj të ketë si barasvlerë mundësinë e shpërndarjes së  
gjuhës e kulturës italiane në Shqipëri;
3. Për të përmbushur këtë qëllim nevojitet të akordohet një  
subvencion prej 150 000 frangash a më shumë, me kushtin që,  
nëse nuk zbatohet në të gjitha shkollat shqiptare, të paktën në ato  
të qyteteve kryesore të jetë i detyrueshëm mësimi i gjuhës italiane;

4. Në këtë frymë mundet të vendoset që një pjesë e subvencionit të vihet në dispozicion të dërgimit për çdo vit në Itali të disa të rinjve shqiptarë për të ndjekur universitetin.

Nuk kam asgjë për të shtuar ndaj vëzhgimeve të sakta të markezit di Sangiuliano, në lidhje me penetrimin ekonomik të Italisë në rajonin me kryeqendër Vlorën.

Për sa i përket hekurudhës Vlorë-Manastir, Shkëlqesia Juaj tashmë i di pikëpamjet e mia dhe nuk është i panjohur me faktin që unë e konsideroj këtë hekurudhë më të leverdishme për interesat italianë, sesa ajo [hekurudha] transballkanike. Edhe në këtë pikë bie në dakordësi me Shkëlqesinë e Tij, markezin di Sangiuliano.

Pranoi, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

## IMPERIALI

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8247-8248

### 5.

#### **Raport i regjentit të konsullatës italiane në Janinë, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, mbi deklaratat e Ismail Qemalit rreth rrezikut që paraqet për Shqipërinë dhe Italinë ekspansioni austriak drejt Lindjes**

Konsullata e Përgjithshme e Madhërisë së Tij, Mbretit të Italisë

*Janinë, 1 nëntor 1908*

Nr. 1230/243

Zoti Ministër,

Kam nderin të transkriptoј në vijim, për Shkëlqesinë Tuaj, sa më ka komunikuar konsulli i Mbretërisë në Vlorë në lidhje me kreun e njohur shqiptar Ismail Bej Qemalin:

Duke konfirmuar mendimin tim mbi politikën helenofile që po ndjek Ismail Bej Qemali (tek e fundit më e mirë sesa një politikë austrofile), kam nderin të raportoj te Zotëria Juaj një bisedë që pata dje me Ismail Beun.

Duke biseduar me të në mënyrë miqësore rreth ngjarjeve të fundit ballkanike, ai më tha se:

*“Austria po e shfaqte haptazi dëshirën për të vijuar marshimin për pushtimin e Lindjes në dëm të Turqisë, Shqipërisë dhe në mënyrë indirekte edhe të Italisë. Shqipëria, e cila rrezikohet në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe më të rrezikshme nga këto synime grabitqare, duhet që të mbështetet tek Italia e drejtë dhe mbështetëse e zgjimit të popullit shqiptar, dhe e interesuar që të ndalojë një pushtim qoftë edhe të pjesshëm të Shqipërisë nga Austria (!!), duke penguar dhe kundërshtuar çdo shkëlje nga ana e Austrisë.”*

Këto ditë mbërritën këtu dy të rinj piemontezë, të rekomanduar tek Ismaili nga italo-shqiptari prof. Chinigo nga Napoli. Duket se bëhet fjalë për blerje në sasi të mëdha lisi në ortakëri me Ismailin. Dje, të gjithë u nisën për në Dukat, një fshat këtu pranë ku ka disa sipërfaqe me lisa pak a shumë fitimprurës. Vetë Ismail Beu më pati përmendur këtë gjë, duke shtuar se me t'u kthyer nga Dukati në varësi të vizitës, kishte dëshirë që të takohej me mua.

Pranoi, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

Regjenti  
**DE SANTO**

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8239-8241

## 6.

### **Raport i ambasadorit italian në Stamboll drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, Tittoni, mbi ambiguitetin e qëndrimit të Ismail Qemalit në lidhje me interesat italianë në Shqipëri dhe orientimin ndaj interesave grekë**

*Pera, 20 nëntor 1908*

Nr. 2644/842

Zoti Ministër,

Duke iu referuar raportit të Shkëlqesisë së Tij markezit di San Giuliano, nr. 460 të datës 17 gusht që më është komunikuar nga ana e Shkëlqesisë Suaj përmes korrespondencës së 13 shtatorit, si dhe raportit

tim nr. 798 të datës 30 tetor, gjykoj me vend të sjell në vëmendjen Tuaj raportin e konsullatës mbretërore në Janinë të datës 24 tetor mbi argumentin “Propaganda austriake në Shqipëri”.

Nga ky raport rezulton se Ismail Bej Qemali, i cili u shfaq kundrejt ambasadorit në Londër tepër i dëshiruar për shpërndarjen e gjuhës dhe të kulturës italiane në Shqipëri, në fakt, me të mbërritur në Vlorë u shfaq si një mbështetës i zjarrtë i shkollave dhe interesave grekë.

Pranoi, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

## IMPERIALI

*AMAE* në *AIH*, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8235

### 7.

#### **Raport përmbledhës i observacioneve të përfaqësuesve diplomatikë italianë, në lidhje me projektin e Ismail Qemalit për zgjimin kombëtar dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë**

*Romë, 10 dhjetor 1908*

#### **Projektet e Ismail Bej Qemalit**

Në raportin e datës 17 gusht nr. 460, ambasadori i Mbretërisë në Londër raporton se ka pasur një takim me Ismail Bej Qemalin, i cili i ka paraqitur një plan veprimi që po e përmbledh në vijim:

Kushtetuta e vitit 1878 nuk i përmbush të gjitha nevojat e kombësive të ndryshme të Perandorisë. Për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e kombit shqiptar është e nevojshme që të gjitha rajonet që i përkasin nga pikëpamja etnike dhe gjeografike të bashkohen në një të vetëm, e më pas t'i njihet një autonomi e gjerë administrative. Italia do të duhet të bashkëpunojë në këtë drejtim; pasi kjo gjë do të sillte rritjen e influencës së saj në rajonin shqiptar.

Duhet përfituruar që në momentin e parë të lirisë politike që gëzon tashmë Turqia, për të hapur menjëherë një numër sa më të madh shkollash shqiptare dhe për të shpërndarë libra të shkruar në këtë gjuhë. Në këtë mënyrë do t'i hapet rrugë zhvillimit të ndërjegjjes kombëtare

shqiptare. Për këtë punë nevojitet një shumë prej rreth 150 000 lirash. Italia do të duhet ta japë menjëherë në mënyrë të fshehtë.

Kapitalistët italianë do të duhet të shpejtojnë të investojnë në Shqipëri kapitalet e tyre në miniera, pyje, vepra publike etj.; dhe të ndajnë një pjesë të fitimeve për të subvencionuar mësimin e gjuhës shqipe.

Duhet studiuar një gjurmë më ekonomike dhe fitimprurëse e linjës hekurudhore Vlorë-Manastir.

Rritja ekonomike e Shqipërisë do të favorizojë vendosjen e stilit të jetesës dhe zakoneve më të qytetëruara dhe të rregullta, në avantazh kjo edhe të Italisë.

Rreth këtij programi ambasadori i Mbretërisë shprehet se nuk është e lehtë për t'u vënë në zbatim, veçanërisht për sa i përket shkëputjes nga Maqedonia të rajoneve shqiptare dhe njohjes së një autonomie të gjerë. Xhonturqit do ta kundërshtojnë autonominë dhe ndarja e rajoneve shqiptare nga Maqedonia do të rindezë luftërat nacionaliste në ato rajone.

Ndërsa hapja e shkollave shqipe, shtypja dhe shpërndarja e librave shqip duket diçka më e lehtë dhe më praktike. Markezi di Sangiuliano shprehet se Italia duhet të ndihmojë financiarisht pa u vonuar në këtë drejtim; kjo nën vazhden e fryteve të favorshme që do të sjellë për ne. Ky ambasador, gjithashtu, thekson se diçka mund të bëhet edhe në fushën ekonomike. Në lidhje me linjën hekurudhore Vlorë-Manastir dhe asaj Stimlia-Shkodër-Shëngjin, thotë se e para mund të duket më me leverdi për interesat tona, por i duhet dhënë përparësi asaj që ka më shumë gjasa që të ndërtohet e para.

Ambasadori i Mbretërisë në Stamboll ndan të njëjtin mendim me atë të ambasadorit në Londër, mbi vështirësitë në zbatim që shfaq nga ana politike programi i Ismail Bej Qemalit.

Vë në dukje se, pavarësisht avantazheve të padiskutueshme që do t'i vijnë Italisë nga hapja e shkollave shqipe në Shqipëri, pikësëpari duhet pritur që të hapë punimet Parlamenti Osman, për t'u njohur me kushtet në të cilat do të autorizohet mësimi i gjuhës shqipe dhe të kërkohet që në shkëmbim të subvencioneve tona për të mundësuar mësimin e gjuhës shqipe të shpërndahet në Shqipëri edhe gjuha e kultura italiane; të vendoset një shumë prej 150 mijë lirash apo edhe më shumë me kushtin që të jetë i detyrueshëm mësimi i gjuhës italiane të paktën në shkollat kryesore të qyteteve, si dhe zotimin për të dërguar në Itali për çdo vit disa studentë shqiptarë për të ndjekur universitetet tona.

Në lidhje me penetrimin ekonomik, markezi Imperiali është plotësisht dakord me ambasadorin në Londër. Edhe ai e gjykon linjën Vlorë - Manastir më të leverdishme, sesa atë transballkanike.

Me të mbërritur në Vlorë, Ismail Bej Qemali i prezantoi projektet e tij edhe te konsulli i Mbretërisë, Poccardi, të cilit madje i thotë se në Romë kishte takuar edhe Shkëlqesinë e Tij nënsekretarin e Shtetit me të cilin kishin rënë dakord për themelimin e një shoqërie me kapital italian për ndërtimin e hekurudhave dhe punëve të tjera publike në Shqipëri.

Shkëlqesia e Tij i nderuari Pompili e ka përgënjeshtuar këtë gjë, duke thënë se me Ismail Bej Qemalin ka biseduar vetëm për mësimin dhe hapjen e shkollave shqipe.

Në disa raste Ismail Bej Qemali i është shprehur zotit Poccardi në terma tepër miqësorë ndaj Italisë, duke shprehur nevojën që ajo të bashkëpunojë për të siguruar të ardhmen e popullsisë shqiptare dhe të pengojë që të zgjerohet në Shqipëri influenza austriake. Po ashtu e ka informuar që është në tratativa e sipër me dy të rinjtë piemontezë për blerjen e disa pyjeve.

Nga ana tjetër, konsulli raporton se Ismail Bej Qemali shfaq ndjenja helenofile; se ndikimi i tij në Shqipëri kohët e fundit është tkurrur dhe nga entuziazmi i tij mbi sipërmarrjet ekonomike që u duhen dhënë italianëve nuk përjashtohen qëllimet për përfitime personale.

*AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8347-8350*

## 8.

### **Informacion i ministrit italian Fuqiplotë në Athinë, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, mbi qëndrimin e Ismail Qemalit në Greqi dhe rreth dyshimeve për marrëveshje të fshehta me qeverinë greke**

[Dorëshkrim]

E rezervuar

*Athinë, 29 prill 1909*

Zoti Ministër,

Qëndrimi i zgjatur i Ismail Bej Qemalit në Athinë, po ngjall shqetësim në ambientet e këtushme zyrtare. Ai është strehuar këtu sikurse ju kam raportuar në datën 21 të këtij muaji.

Me të drejtë apo jo, kryetari i Partisë Nacionaliste Osmane ka qenë gjithnjë i dyshuar për marrëveshje sekrete me Greqinë në lidhje me Epirin, madje është akuzuar se kundrejt pagesës ka vënë në dispozicion të helenizmit influencën që ka në Shqipëri.

Tanimë Komiteti shqiptar i Selanikut, i njohur për lidhjet e tij me [Komitetin] “Bashkim e Përparim”, ka shpërndarë një qarkore telegrafike tek të gjitha klubet shqiptare ku denoncon arratinë e Ismail Qemalit në Athinë dhe e akuzon se po komploton me qeverinë greke për të shkaktuar trazira në Shqipëri. Nga ky fakt ka lindur edhe frika e qeverisë helene, se mos komprometohet përpara xhonturqve dhe opinionit publik europian.

Jam duke ndjekur me vëmendje dhe vigjilencë të posaçme të gjitha lëvizjet e Ismail Bej Qemalit në këtë kryeqytet. Kolegu im i Turqisë, që është më tepër i interesuar për këtë gjë, nuk ka hezitur të më raportojë në lidhje me të.

Nga informacionet që kam në dispozicion rezulton se gjendja e sikletshme politike dhe financiare e Ismail Bej Qemalit mund të lë vend për veprime të pakujdesshme nga ana e tij, por nuk ka asnjë arsye që qeveria greke t’u vë veshin miklimeve të tij. Më rezulton se Ministria e Punëve të Jashtme po kërkon një arsye për të larguar mikun e rrezikshëm, gjë që do ta kishte bërë me kohë po të mos ekzistonte droja se në këtë mënyrë do të preknin ndjenjat e ndonjë personaliteti të opozitës, që për arsye patriotike vijon të mbrojë Ismail Qemalin.

Ruaj të drejtën t’i rikthehem sa më parë këtij argumenti. Ndërkohë, përfitoj nga rasti t’ju rinovoj ndjenjat e respektit tim të thellë.

**CARLOTTI**

*AMAE* në *AIH*, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8226-8229

## 9.

### **Informacion i konsullit italian në Korfuz për ministrin e Punëve të Jashtme, mbi vajtjen e Ismail Qemalit në Korfuz dhe situatën delikate të azilantëve shqiptarë atje**

Konsullata e Përgjithshme e Madhërisë së Tij, Mbretit të Italisë  
Ishujt Jonianë

*Korfuz, 3 maj 1909*

Zoti Ministër,

Ka mbërritur nga Athina, ku banon, epiroti nga Vlora Ismail Bej Qemali. Ardhja e tij sikurse më është referuar nga një person i mirinformuar rreth fakteve dhe mik me vetë Ismail Qemalin, u atribuohet ngjarjeve në vijim:

Jo pak epirotë, kuptohet myslimanë, erdhën të kërkojnë azil në Greqi për t'i shpëtuar në këtë mënyrë persekutimit dhe përndjekjes të të ashtuquajturve komitete të xhonturqve. Prej tyre, nja njëzet veta gjetën strehim në Korfuz. Nuk ka shumë kohë që shefi i policisë me urdhër të prefektit i ka ftuar në mënyrë të sjellshme që të largohen prej këtej. Në lidhje me këtë njoftuan me telegraf Ismail Bej Qemalin në Athinë, dhe po përmes telegrafit ky ka urdhëruar që të mos lëvizin vendit.

Në fakt, duket se prefekti ka marrë urdhra nga Athina që të mos i ngacmojë, por t'i lejojë që të qëndrojnë të qetë në Korfuz. Sikurse thashë: ardhja e Qamil Beut para dy ditësh ka të bëjë me këtë gjë, pasi ai është mbrojtësi i këtyre njerëzve dhe paguan nga xhepi i tij shpenzimet për një pjesë të tyre. Nga ana tjetër, nuk duhet të mos i japim peshën e duhur një versionit tjetër mbi praninë e tij këtu. Qamil Beu, me sa duket, është ftuar nga qeveria që të largohet nga Athina dhe ndoshta i është lejuar që të qëndrojë përkohësisht në Korfuz.

Qeveria greke gjendet në siklet të madh. Për shkak të Kretës nuk dëshiron të ngjallë pakënaqësi të qeveria turke, e cila i kërkon që të mos u japë azil njerëzve të përndjekur nga komitetet e xhonturqve; dhe nga ana tjetër për hir të aspiratave që ka në Epir nuk dëshiron që të armiqësojë elementin mysliman të atyre anëve, mbi të cilët do të mund të mbështetet në një revoltë të mundshme kundër turqve duke qenë se janë jo vetëm më të shumtë në numër, por edhe më të fortë dhe më kurajozë se të krishterët ortodoksë. E kështu i lëvizin sa në njërin vend në një vend tjetër të Greqisë këta njerëz të shkretë që gjenden të shpërndarë mes Korfuzit, Patras dhe Athinës, me shpresën se në këtë mënyrë do të mund të kënaqin njerërin palë dhe nuk do të zemërojnë palën tjetër.

Pranoni, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

[Firma]

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8230-8232

## 10.

### **Informacion i konsullit italian në Janinë drejtuar ministrit të Jashtëm, mbi pozitat e lëkundura të Ismail Qemalit dhe Myfid Bej Libohovës pas ardhjes në pushtet të xhonturqve**

[Dorëshkrim]

Konsullata e Përgjithshme e Madhërisë së Tij, Mbretit të Italisë

*Janinë, 8 maj 1909*

Nr. 448/84

*Lënda:* Deputetët shqiptarë Ismail Bej dhe Myfid Bej. Gjendja në Vlorë.

Zoti Ministër,

Sikurse tashmë Shkëlqesia Juaj duhet të jetë në dijeni, në kohën kur trupat ushtarake iu afruan Kostandinopojës, dy deputetët shqiptarë Ismail Bej Qemali i Vlorës dhe Myfid Beu i Gjirokastrës morën arratinë nga qyteti dhe vajtën në Athinë.

Që të dy i druheshin fitores së xhonturqve, por, për arsye të ndryshme. Përrjashtohet nga të gjithë mundësia që Myfid Beu të jetë reaksionar dhe të ketë qenë i lidhur me autorët e lëvizjes së famshme të 13 prillit të kaluar. Arsyeja se përse ia mbathi ka lidhje me faktin se, duke qenë një deputet shqiptar me influencë dhe për shkak të ideve të tij për një sistem qeveritar të decentralizuar për provincat e Turqisë në Europë, do të shihej si person i dyshimtë nga ana e xhonturqve dhe nuk do t'i jepej kohë për të vërtetuar se nuk kishte asnjë lidhje me lëvizjen.

Korrespondenti ynë në Gjirokastër më shkruan se i rezulton që Myfid Beu këto ditë nga Athina i ka drejtuar një letër bashkiakut të Gjirokastrës, në të cilën i shpjegon arsyet që e detyruan të marrë arratinë nga Kostandinopoja, për shkak të akuzave të rreme që u vinin për shtat deputetëve shqiptarë liberalë ndaj kundërrevolucionarëve monarkistë të

kryeqytetit, dhe i lutet që të sigurojë zgjedhësit se sapo të qetësohet situata ai do ta provojë në mënyrë të pakundërshtueshme pafajësinë dhe do të kërkojë të drejtën e tij për t'u rikthyer në Dhomën e deputetëve.

Për sa i përket Ismail Bej Qemalit, mendimet janë të ndryshme dhe askush nuk do të vinte dorën në zjarr mbi devotshmërinë e tij ndaj idealeve liberale dhe konstitucionale. Për shumë njerëz ai nuk është veçse një oportunist, i cili nuk heziton të përfitojë nga çdo rast për t'u evidentuar dhe për të gjetur mënyra që të ndihmojë përmes një pozite të mirë politike financat private jo dhe aq të lulëzuara. Ata që nuk ushqejnë besim te patriotizmi dhe liberalizmi i Ismail Bej Qemalit u referohen ndjenjave të tij helenofile të shfaqura më shumë sesa një herë, të papajtueshme me interesat dhe zhvillimin e Perandorisë në përgjithësi dhe në veçanti me atdheun shqiptar, si dhe kujtojnë madje apo pretendojnë të kujtojnë se ai gjatë një periudhe të caktuar është subvencionuar në mënyrë të fshehtë nga qeveria greke.

Edhe Ismail Bej Qemali ka menduar që të justifikohet para zgjedhësve të tij. Regjenti i zv. konsullatës sonë në Vlorë më referoi për një telegram të tij [I. Qemalit], drejtuar nga Greqia klubit shqiptar të qytetit të Vlorës me përmbajtje si vijon:

*“Me rënien e Sulltan Abdülhamitit mori fund njëherë e përgjithnjë regjimi i urryer që rrëronte shtetin dhe dëmtonte kombin. Armiqtë e mi përmes shpifjeve të ulëta më kanë ngarkuar fajin e trazirave të fundit, por për fat të mirë akuzat e tyre nuk mund të shkaktojnë asnjë paragjykim ndaj ndershmërisë dhe besnikërisë sime për të cilat po luftoj që prej 33 vitesh; shqiptarët janë të bindur.*

*Tashmë të gjithë ne duhet të kemi besim të madh se me rrëzimin e Sovranit do të vendoset regjimi i drejtësisë dhe i barazisë dhe që të gjithë duhet të punojmë të bashkuar dhe me gjakftohtësi për rivendosjen e rendit e qetësisë në Perandori.”*

Por ama, jo të gjithë janë në solidaritet me Ismail Bej Qemalin, madje edhe në rrethin shqiptar të Vlorës, dhe as nuk do ta mbështesnin atë pa kushte.

Duhet të shtojmë se në paragjykimin ndaj tij ndikojnë së tepërmi jehonat e intervistave të shumta që ai vijon t'u japë korrespondentëve të gazetave greke nga ekzili i tij i përkohshëm, të cilat riprodhohen me një kënaqësi të dukshme në gazetatat më në zë të shtypit helen.

Ndërkohë, për të shmangur mundësinë e trazirave në Vlorë nga ana e mbështetësve të Ismail Bej Qemalit, garnizoni i qytetit është rirforcuar në

mënyrë të ndjeshme dhe kanë mbërritur atje për ta parë situatën nga afër mytesarifi i Gjirokastrës dhe komandanti i regjimentit të xhandarmërisë me seli në Janinë, ky i fundit i shoqëruar edhe me xhandarë mbi kuaj.

Nuk është e pavend që të vëmë në dukje se edhe emërimi në postin e ministrit të Brendshëm të kabinetit të ri qeveritar në Kostandinopojë të ish-Vezirit të Madh Ferid Pasha, i njohur si armik personal dhe politik i Ismail Bej Qemalit, është konsideruar nga të gjithë si një provë e qëllimit të palëkundur të xhonturqve për të hequr qafe apo të paktën për t'i bërë të padëmshme radhët e mbështetësve të Ismail Bej Qemalit në të gjithë Shqipërinë.

Një kopje e këtij raporti i transmetohet ambasadës së Mbretërisë.

Me respekt,

**AUGUSTO STRANIERI**<sup>4</sup>

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8211-8225

## 11.

### **Informacion i ministrit italian Fuqiplotë në Athinë, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, mbi ngritjen e një komisioni hetimor në Parlamentin Turk për verifikimin e akuzave ndaj Ismail Qemalit dhe Myfid Beut**

*Athinë, 9 maj 1909*

[Dorëshkrim]

Nr. 550/221

E rezervuar

Zoti Ministër

Në zbatim të urdhrit të qeverisë së tij, ministri i këtushëm i Turqisë ka informuar ministrin e Punëve të Jashtme se Dhoma e deputetëve të Parlamentit Osman ka emëruar një komision të posaçëm parlamentar me detyrën për të verifikuar akuzat e ngritura kundër deputetëve Ismail bej Qemali dhe Myfid Bej, aktualisht të strehuar në Greqi, të cilët akuzohen se kanë tentuar të organizojnë një kryengritje në Shqipëri dhe se për këtë

<sup>4</sup> Augusto Stranieri - Konsull i Përgjithshëm në Janinë.

qëllim kanë dërguar atje një numër të madh armatimesh dhe municionesh. Qeveria osmane përmes ministrit të saj i bën apel qeverisë helene në emër të marrëdhënies të mira të cilat ekzistojnë mes dy palëve, të lehtësojë punën e komisionit në hetimet që duhet të bëjë në lidhje me rastin në fjalë.

Ministri i Punëve të Jashtme i është përgjigjur Nabi Beut, gjithashtu, duke i motivuar deklaratat e tij me marrëdhëniet e mira mes dy vendeve, pasi nuk i rezulton të jenë të vërteta asnjë prej pretendimeve të ngritura ndaj Ismail Bej Qemalit dhe Myfidit në Shqipëri, dhe se, në lidhje me dërgimin e armëve nga ana e tyre nuk duhet të ngrihet as më i vogli dyshim ndaj Greqisë, sinqeriteti dhe korrektesa e së cilës qëndron sipër çfarëdolloj trillimi nga ana e të papërgjegjshmëve.

Nga sa më referojnë në mënyrë konfidenciale zoti Baltaggi dhe Nabi Beu, dyshimet e ushqyera në Kostandinopojë nga gjeneralissimo Mahmut Shefqet Pasha që i ka raportuar në seancën e datës 5 të këtij muaji në Parlamentin Osman, kanë të bëjnë më tepër me raportet e mëparshme të Ismail Qemalit me Abdülhamitin dhe me disa reaksionarë të njohur, sesa me veprimtarinë e tij si agjikator pas ardhjes në Greqi.

Dërgimi i armëve që kam sinjalizuar te Shkëlqesia Juaj përmes raportit nr. 237 më datë 1 të këtij muaji, nuk ka të bëjë me praninë e Ismail Qemalit në Athinë dhe me asnjë fakt tjetër të ngjashëm që të mund të prezumojë se ka lidhje me të.

Për më tepër, më duket se në qeveri ndryshe nga ditët e para, tani mbizotëron bindja e influencës së shkuar të Ismail Qemalit në Shqipëri ashtu si dhe dëshira për largimin e tij po bëhet gjithnjë e më e theksuar; aq sa me iniciativë të ministrit të Punëve të Jashtme janë bërë presione zyrtare ndaj këtij refugjati, për ta bindur që të largohet nga territori grek.

Pranoni, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

**CARLOTTI**

**12.****Informacion i ministrit italian Fuqiplotë në Athinë drejtuar ministrit të Jashtëm, mbi kërkesën e Kryeministrit grek ndaj Ismail Qemalit për t'u larguar nga Greqia***Athinë, 16 maj 1909*

[Dorëshkrim]

Nr. 572/253

E rezervuar

Zoti Ministër,

Në vijim të raportit tim të datës 9 të këtij muaji me nr. 251, kam nderin të informoj Shkëlqesinë Tuaj se në një takim që u zhvillua sot mes Ismail Qemalit dhe Shkëlqesisë së Tij, Presidentit të Këshillit të Ministrave, ky i la haptazi të kuptojë dëshirën e qeverisë helene që qëndrimi i tij në Greqi të mos zgjatet më tej. Ismail Qemali i është përgjigjur zotit Teotochis se do të largohej pas pak ditësh.

Pranoni, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

**CARLOTTI**

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8220

**13.****Informacion i ministrit italian Fuqiplotë në Athinë, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, mbi kërkesën e qeverisë greke për largimin e Ismail Qemalit nga Greqia dhe vendimin e tij për t'u vendosur në Napoli***Athinë, 30 maj 1909*

[Dorëshkrim]

Nr. 619/289

Konfidenciale

Zoti Ministër,

Më rezulton se qeveria helene ka bërë hapa të tjerë pranë Ismail Bej Qemalit për ta bindur që të largohet nga Greqia dhe, me sa duket, ai ka vendosur që të niset në datën 1 qershor për në Korfuz ku gjendet familja e tij dhe më pas do të shkojë në Napoli ku ka vendosur të stabilizohet. Prej andej ai do të lëvizë për në Romë, Paris dhe Londër.

Qëndrimi i tij në Athinë nuk ka munguar që të ngjallë dyshime në Kostandinopojë dhe sipas mendimit të përbashkëtimit dhe të kolegëve të mi ka pasur pasoja. Informacione të rezervuara ma konfirmojnë këtë gjë. Një lloj mosbesimi ndaj tij dhe më pas sukcesi në lidhje me çështjen e Kretës kanë ngjallur interes edhe pranë njerëzve që nuk kanë lidhje me qeverinë me të cilët është zënë me fjalë, ndaj argumenteve hipnotizuese me të cilat ai mbante diskutimet.

Vetë ai duket më i shqetësuar për pafajësinë dhe të ardhmen e tij, sesa për propagandën politike. Letra e tij e shfajësimit drejtuar Parlamentit Osman, synimi për të nxitur ambasadorin e këtushëm osman që të ndërmjetësojë në favor të tij në Kostandinopojë, sikurse edhe tentativat në këtë drejtim pranë ministrit të këtushëm të Turqisë, tregojnë më tepër mbi dëshirën e tij për të rimarrë postin në Dhomën e deputetëve, sesa për ringritjen e Shqipërisë. Për më tepër që ka dyshime se në Shqipëri ai ende mund të ketë ndikimin e dikurshëm. Arratia e disa prej ithtarëve të tij në Korfuz dhe në Bari nuk ka ardhur si pasojë e revoltës, por prej panikut të shkaktuar nga lufta elektorale në Vlorë dhe në Berat si një luftë më tepër për influencë personale mes tij dhe të kushëririt Ferid Pasha, sesa për parimet autonomiste. Shqipëria nuk ngrihet në revoltë për së largu dhe as nën tingullin e fjalëve; ai e di, por nuk ka ndërmend të kthehet atje; i njeh tepër mirë shqiptarët dhe Feridin, sikurse dhe të vëllanë Namikun që aktualisht gjendet në Vlorë.

Nëse duke u bazuar te faktet rezulton plotësisht e pamundur që në këto momente Ismail Qemali të ushtrojë apo të mund të ndërmarrë një veprim politik apo një revoltë në Shqipëri, duhet të pranojmë se pikërisht për këto gjëra ai është akuzuar si autor në qarqet qeveritare dhe në shtypin e Kostandinopojës, që përfshin në dyshim vendet në të cilat ai shkon. Nga ky këndvështrim, ardhja e tij në Itali mund të na shkaktojë siklet, por, sipas mendimit tim, për këtë gjë do të mendojë pikërisht ambasadori i Turqisë këtu, i cili do të dijë t'i japë këshillat e duhura këtij refugjati dhe qeverisë osmane.

Pranoni, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

**CARLOTTI**

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8209-8213

**14.**

**Informacion i konsullit italian në Korfuz për ministrin e Jashtëm,  
mbi largimin e Ismail Qemalit nga Korfuzi me kërkesë të  
autoriteteve greke**

Konsullata e Përgjithshme e Mbretërisë së Italisë në Ishujt Jonianë

*Korfuz, 4 qershor 1909*

Nr. 273/67

Zoti Ministër,

Në vijim të raportit tim nr. 270/65 marr të drejtën t'ju informoj se Ismail Bej Qemali është larguar dje me anijen postare italiane për në Brindisi së bashku me të gjithë familjen. Prej andej besojmë se do të vijojë për në Napoli, ku do të jetë vendbanimi i tij për aq kohë sa do të zgjasë situata aktuale politike në vendin e tij. Largimi i Ismail Bej Qemalit konfirmon versionin të cilin kam raportuar në raportin tim të sipërcituar: që ndoshta ai është ftuar që të largohet nga Greqia.

Më rezulton që kjo kërkesë i është bërë me mirësjelljen e duhur; sikurse më rezulton nga informacione specifike se prefekti i këtushëm është interesuar së tepërmi në favor të tij, për shkak të një çështjeje që Ismail Bej Qemali ka këtu në lidhje me një shtëpi të cilën e pati marrë me qira, por më pas qe shtrënguar ta lëshojë në vijim të kërkesës për t'u larguar nga Greqia.

Më duhet të theksoj, gjithnjë në vijim të raportit në fjalë, se epirotët që janë strehuar këtu vijnë nga Epiri i Epërm, dhe shumë pak janë nga Shqipëria, që të themi të drejtën janë myslimanë. Elementi epirot i krishterë ortodoks është tërësisht i huaj për sa i përket rebelimit aktual epiro-mysliman.

Pranoni, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

[Firma]

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8190-8191

## 15.

**Informacion i ministrit italian Fuqiplotë në Athinë, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, mbi largimin e Ismail Qemalit nga Korfuzi për në Brindisi dhe qëndrimin e tij të moderuar ndaj qeverisë xhonturke**

*Athinë, 7 qershor 1909*

[Dorëshkrim]

Nr. 6440/301

E rezervuar

*Lënda:* Qemal Bej

Zoti Ministër,

Nga një raport që konsulli i Përgjithshëm i Turqisë në Korfuz i ka drejtuar ministrit të këtushëm osman, rezulton se Ismail Qemali ka mbërritur atje më datën 2 të këtij muaji dhe është rinisur më datën 3 së bashku me familjen për në Brindisi. Në imbarkimin e tij në bordin e “Elettrico” të Navigazione Generale Italiana, asistuan dhjetë shqiptarë nga Delvina, të cilëve kur po ndahej ai iu drejtua me zë të lartë që të ruanin qetësinë dhe besimin ndaj qeverisë së Kostandinopojës.

Gjithashtu nga raporti i mësipërm rezulton se prefektura e Korfuzit i ka lënë të kuptojë Ismail Qemalit se ai nuk mundej të qëndronte për shumë kohë në ishull.

Edhe në intervistat që ai u ka dhënë disa gazetarëve në Patrasso vërehet gjuha e tij e kujdesshme ndaj regjimit të ri në Turqi dhe përpjekjet e tij për të hedhur poshtë akuzat për veprimtari antipatriotike, por duke insistuar mbi mospërputhjet e tij politike me Partinë [Komitetin] “Bashkim e Përparim”.

Pranoni, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

**CARLOTTI**

*AMAE* në *AIH*, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8187-8189

**16.**

**Kërkesë e konsullit italian në Janinë drejtuar ministrit të Jashtëm,  
ku kërkon udhëzime mbi qëndrimin që duhet mbajtur ndaj Ismail  
Qemalit dhe partisë së tij**

*Janinë, 22 gusht 1909*

[Dorëshkrim]

Nr. 783/143

Zoti Ministër,

Flitet se lideri i famshëm i Partisë Liberale Shqiptare, Ismail Bej Qemali, i cili pas lëvizjes reaksionare të prillit të kaluar që i shtrënguar të merrte arratinë nga Turqia, gjendet prej shumë muajsh në Romë, ku madje është pritur nga personazhe të autoritetshme të politikës sonë.

Partia e Ismail Bej Qemalit është ende e fortë në Vlorë dhe në të gjithë Shqipërinë e Poshtme, e ndoshta do të ishte e dobishme që kjo konsullatë e Përgjithshme të informohet për ngjarjet e fundit që i kanë raportuar qeverisë mbretërore, qëndrimin që duhet të mbajnë ndaj Ismail Qemalit dhe grupimit të cilin ai përfaqëson.

Në çdo rast, do të isha mirënjohës nëse Shkëlqesia Juaj do të më transmetojë udhëzimet në lidhje me këtë çështje.

Me respekt,

**AUGUSTO STRANIERI**

*AMAE* në *AIH*, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8168-8169

## 17.

**Telegram i ambasadorit italian në Stamboll drejtuar ministrit të Jashtëm, ku informon mbi lëvizjet subversive të Ismail Qemalit në Shqipëri**

Ambasada italiane në Cospoli

Telegram nr. 2955

*Terapia,<sup>5</sup> 27 gusht 1909 ora 12:40*

*Romë, 27 gusht 1909 ora 14:55*

Nr. 436. E rezervuar.

Porta e Lartë dje ka marrë një telegram, ku ambasadori i Turqisë njofton se Ismail Qemali u ka dërguar shqiptarëve në mënyrë klandestine një shpallje subversive. Ambasadori këshillon që të merren masa të rrepta ushtarake në Shqipëri dhe veçanërisht në vilajetin e Janinës.

Në lidhje me këtë informacion e gjykoj me vend që të lajmërohet në mënyrë konfidenciale Stranieri, i cili do të duhet t'i këshillojë zëvendëskonsullit në Vlorë që të tregohet tejte i kujdesshëm në marrëdhëniet e tij me nënshtetasit osmanë atje.

Pres urdhra për t'i telegrafuar Stranierit për llogari të Shkëlqesisë Suaj.

**IMPERIALI**

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8170

## 18.

**Informacion i Ministrisë së Brendshme drejtuar Ministrisë së Jashtme, mbi lëvizjet e Ismail Qemalit në Itali dhe tentativat e tij për të organizuar në Paris tubime kundër Sulltanit**

Ministria e Punëve të Brendshme

Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Publike

Romë

Drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme - Romë

<sup>5</sup> *Tarabaya*, rezidenca verore në Bosfor e përfaqësive diplomatike.

Romë, 17 shtator 1909

E rezervuar  
Nr. 17747

Përgjigje ndaj tuajës datë 31 gusht, nr. 137/844-Div. III-Seksioni. II.  
Ismail Qemali

Në përgjigje të shkresës së kësaj ministrie të nderuar, sikurse është shënuar më lart, po transkriptoј në vijim letrën e prefektit të Romës:

Kam nderin t'i bëj me njohje kësaj ministrie të nderuar se nënshtetas osman Ismail Bej Qemali, deputet i Parlamentit Turk, përfaqësues i Beratit (Shqipëri) duke ardhur nga Napoli mbërriti në Romë më datë 18 qershor dhe qëndroi në hotelin "Michel" në rrugën "Torino", nr. 38 dhe u rinis për në Napoli në datën 10 korrik.

Gjatë kësaj kohe ai u përpoq t'i afrohej deputetit Fortis, me siguri ka folur me deputetin De Marinis, me prof. De Gubertis, dhe ka pasur disa takime në hotel me gjeneralin Ricciotti Garibaldi.

Korrespondenca që merrte ka qenë tepër voluminoze dhe vinte nga çdo cep i Europës e veçanërisht nga Kostandinopoja.

Qemali nuk është paraqitur asnjëherë pranë ambasadës apo konsullatës turke.

Më 16 gusht u kthye në Romë së bashku me të shoqen dhe ka qëndruar në hotel "Continental" dhe ditët në vijim në hotel "Michel", nga ku u nis për në Napoli mbrëmjen e datës 23 me trenin e orës 19:45.

I sinjalizuar te kuestura e Napolit për t'u mbajtur nën vëzhgim, kjo ka referuar në lidhje me këtë shtetas të huaj sa vijon:

*"Ismail Bej Qemali i moshës rreth 60- vjeçare, së bashku me gruan dhe pesë fëmijët, prej dy muajsh janë strehuar në pensionin Fasulo&Stellone në rrugën "Carcciolo" nr. 16.*

*Do të vijojë të qëndrojë këtu ende për disa kohë dhe më pas do të shkojë të vizitojë qytete të tjera të Italisë. Para rreth një muaji u transferua në Romë, ku qëndroi për rreth pesëmbëdhjetë ditë.*

*Më parë shtëpia e tij ka qenë e frekuentuar prej dhjetë shqiptarësh, që tani duket se janë larguar. Ai bën një jetë vetmitare dhe të tërhequr, e kalon kohën e lirë duke lexuar gazeta dhe shkruar letra. Del rrallë për të shkruar në Gambrinus ose në kafenenë "Calzona". Për çdo rast kemi marrë masat për ta mbajtur nën vëzhgim të posaçëm.*

Kuestura e Napolit përmes telegramit të datës 8 ka sinjalizuar nisjen e tij për në Romë në datën 6 të këtij muaji, dhe njoftonte se familja e Qemalit kishte qëndruar në Napoli në pensionin e zakonshëm.

Por ai nuk mbërriti në Romë, dhe rezultoi se ka shkuar në Paris për të organizuar manifestime dhe tubime kundër Sulltanit të tanishëm. Duke qenë se nuk e realizoi qëllimin e tij, është larguar nga Parisi dhe ka mbërritur më datën 12 në Romë, ku ka qëndruar në një shtëpi private në rrugën “Firenze”, nr. 43. Mbrëmjen e së nesërme, datë 13 është nisur për në Napoli, i sinjalizuar tek autoritetet e atjeshme të rendit publik për vëzhgim efikas dhe i shoqëruar nga një agjent civil.

Shtoj për informacionin tuaj se, në gazetën “Giornale d’Italia” nr. 287 të datës 25 gusht, në dy kolonat e para të faqes së parë është publikuar një intervistë me tematikë politike e një korrespondenti të kësaj gazete me Ismail Qemalin.

Për ministrin  
[Firma]

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8172-8174

## 19.

### **Shkresë e Ministrisë së Brendshme për Ministrinë e Jashtme, ku jepet informacion mbi lëvizjet e Ismail Qemalit në Itali**

Ministria e Punëve të Brendshme  
Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Publike - Romë  
Drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme - Romë

*Romë, 13 tetor 1909*

E rezervuar  
Nr. 19991

Në vijim të raportit të kësaj ministrie datë 17 shtator me nr. 17747, komunikoj se deputeti turk Ismail Bej Qemali, mbërriti dje në Romë nga Napoli i pajisur me biletë ndërkombëtare Napoli-Paris, ka vijuar menjëherë me linjën e Pizës, i ndjekur gjithnjë nga një agjent i aftë.

Jam në pritje të informacioneve të tjera.

Për ministrin  
[Firma]

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8171

## 20.

**Raport i ambasadorit italian në Londër drejtuar ministrit të Jashtëm mbi bisedën me Ismail Qemalin në lidhje me qëndrimin e tij ndaj qeverisë xhonturke, të cilën e cilëson si armiqësore ndaj aspiratave kombëtare të popujve të Perandorisë; mbi pozitat e lëkundura të tij në Komitetin “Bashkim e Përparim”; si dhe kërkesën për mbështetje financiare për sipërmarrjen e tij në ndërtimin e hekurudhës Vlorë - Manastir**

Ambasada e Mbretërisë së Italisë në Londër  
Nr. 1328/537

*Londër, 21 tetor 1909*

*Lënda: Biseda me Ismail Bej Qemalin*

Zoti Ministër,

Dje erdhi të më takojë Ismail Bej Qemali, mjaft i njohur te Shkëlqesia Juaj. Më tha se do të nisej shumë shpejt për në Vlorë dhe Kostandinopojë duke bërë një ndalesë disaditore në Romë.

U ankua për qëndrimin e qeverisë sonë ndaj refugjatëve shqiptarë në Itali dhe kërkon që Italia të garantojë interesat e një kompanie, që ai do të themelojë për ndërtimin e hekurudhës Vlorë-Manastir. Ai gjykon se politika e tanishme e xhonturqve është shkatërrimtare për Perandorinë Osmane: qeveri okulte, pa përvojë, e korruptuar, ofensive ndaj ndjenjave dhe interesave legjitimë të kombësive të ndryshme të Perandorisë, përdor lajkat që i bën Europa, e cila në fakt duhet që t'i tërheqë veshin herë pas here.

Sipas tij, regjimi aktual është shumë herë më i keq sesa ai i Abdülhamitit, dhe do të shkaktojë një shpërthim që do të jetë me shumë gjasa më i mirorganizuar sesa ai i 13 prillit të kaluar, si dhe do të bëjë të mundur vendosjen e një regjimi më të drejtë dhe liberal. Nuk ka nevojë

që të shtoj këtu se regjimi i drejtë dhe liberal, nuk mund të jetë tjetër gjë përpos atij nga i cili ai mund të përfitojë ndonjë avantazh.

Ismail Bej Qemali ankohet për sër Gerald Lowter, i cili, sipas tij, nuk e ka kuptuar mirë situatën dhe do të kishte mundur të kishte qenë më i vlefshëm në prillin e kaluar.

Beson se Haki Bej, tashmë ambasador në Romë, aspirojnë të bëhet më vonë *Talleyrand* i Turqisë. Tregoi se xhonturqit nuk kanë besim tek ai dhe se në një mbledhje sekrete të Komitetit propozuan masa të rënda kundër tij. Njëri nga anëtarët e Komitetit i doli në mbrojtje, dhe për atë herë u vendos që të vijohej të konsiderohej si mik, por një nga oficerët e rinj u betua se do ta vriste me dorën e tij në gabimin më të parë dhe një tjetër shtoi se të njëjtin fat do të kishte edhe mbrojtësi i tij.

Ismail Bej Qemali thotë se nuk i di emrat e anëtarëve të Komitetit “Bashkim e Përparim”, por nuk beson aspak te ndershmëria e tyre personale, aq më tepër që, ata që njihen shpenzojnë shumë dhe nuk dihen burimet e parave të tyre.

Ai beson se Abdülhamiti mbeti i kënaqur nga lëvizja e 13 prillit, por nuk i cyti pasi nuk donte të rikthehej në absolutizëm, si për punën e madhe që i kërkonte ai lloj regjimi ashtu edhe sepse e kuptonte se shkelja e Kushtetutës do të sillte pasoja të rënda.

Madje më tha se Abdülhamiti ka këmbëngulur gjithnjë për një hetim, i sigurt që do të provonte se ai nuk ishte përgjegjës për trazirat.

Pranoi, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

[Firma]

**SANGIULIANO**

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8165-8167

## 21.

**Raport i ambasadorit italian në Stamboll për ministrin e Jashtëm, kontin Guicciardini, mbi bisedën me Ismail Qemalin në lidhje me çështjen e alfabetit shqip dhe mbi projektet e ndërtimit të linjave hekurudhore Danub-Adriatik dhe Vlorë-Manastir**

*Kostandinopojë, 12 mars 1910*

*Lënda: Takimi me Ismail Bej Qemalin*

Zoti Ministër,

Disa ditë më parë pata një takim mjaft të gjatë me Ismail Bej Qemalin, deputet i njohur i Vlorës.

Ai mbi të gjitha më foli rreth çështjes së alfabetit shqiptar. Shkëlqesia Juaj njih përmes raporteve të konsujve në Manastir, Shkup dhe Shkodër, detajet e çështjes dhe trazimin që kjo ka ngjallur mes shqiptarëve të Jugut dhe të Veriut. Ismail Qemali, i cili e di që Veziri i Madh këmbëngul me forcë për përdorimin e germave arabe, sheh në këtë qëndrim të qeverisë osmane tendencën për të shkombëtarizuar shqiptarët, dhe më kërkon që të ndërhyj te Haki Pasha në mbështetje të aspiratave të bashkëkombësve të tij, të cilët po revoltohen pasi duan që të përdoren germa latine. Por, një hap i tillë do të përbente një ndërhyrje të pastër nga ana ime në një çështje të brendshme kaq delikate, gjë e cila do të ishte mirë të shmangej. Për më tepër, ai që e kërkon, përveçse është kreu i njërit prej grupeve parlamentare të opozitës, është një person mbi moralitetin e të cilit qarkullojnë gjykime nga më të ndryshmet. Duke pasur parasysh personalitetin e bashkëbiseduesit tim, nuk desha që t'i jepja një përgjigje të prerë negative dhe preferova të përgjigjem në mënyrë evazive.

Më pas, Ismail Bej Qemali më foli për hekurudhën Danub-Adriatik, duke më deklaruar se shqiptarët e kundërshtojnë me vendosmëri pasi e konsiderojnë realizimin e saj si një avancim kërcënues të sllavizmit; dhe se do të bëjnë të mundurën dhe të pamundurën që të pengojnë ndërtimin e saj. "Ndërsa hekurudha që dëshirojnë shqiptarët, - më tha ai, - është ajo Vlorë-Manastir". Pasi më rrëfeu se është në kontakt me kapitalistë anglezë, të gatshëm për të investuar në këtë sipërmarrje, ai më kërkoi mbështetjen e qeverisë mbretërore për zbatimin e kësaj linje hekurudhore.

Edhe në lidhje me këtë pikë e gjykova që të mbaj ndaj Ismail Bej Qemalit një qëndrim të kujdesshëm dhe të rezervuar. Në fakt, nuk mundesha të mos kisha parasysh përkrahjen e dhënë nga qeveria mbretërore për projektin Danub-Adriatik sikurse dhe zotimet e marra me Rusinë, apo takimet e mëparshme me kolegun tim gjerman në lidhje me

linjën Vlorë-Manastir, dhe së fundmi dispozitat e përgjithshme të qeverisë osmane për ndërtimin e hekurudhave, të cilat erdhën si rezultat i takimeve të fundit të zotit Milovanovich me Vezirin e Madh për linjën Danub-Adriatik. (Raporti im nr. 416/145 i datës 10 të këtij muaji).

Prandaj i thashë Ismail Bej Qemalit se, nëse kapitalistët anglezë ishin të gatshëm për të investuar në këtë sipërmarrje, mundej që nga ana e tij t'i vinte në kontakt me kapitalistët italianë.

Në këtë pikë biseda u ndërpre.

Sipas fjalës që i thashë Ismail Bej Qemalit, është detyrë imja që, në ardhjen time më të parë në Romë, të komunikoj sa më sipër drejtpërdrejt te Shkëlqesia Juaj: meqenëse nisja ime nga Kostandinopoja është shtyrë për mjaft kohë, vendosa që t'jua raportoj me shkrim bisedën time me deputetin shqiptar, përveçse do t'jua përcjell gojarisht edhe shpjegimet e mëtejshme që Ju do të dëshironi.

Shpresoj se përgjigjet që i dhashë deputetit të Vlorës të kenë pëlqimin e Shkëlqesisë Suaj.

Nderimet e mia

**IMPERIALI**

*AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8153-8155*

## 22.

### **Raport i ministrit Fuqiplotë të Italisë në Malin e Zi drejtuar ministrit të Jashtëm, Sangiuliano, mbi bisedën me Ismail Qemalin në lidhje me kryengritjen e Malësisë**

Legata e Madhërisë së Tij, Mbretit të Italisë në Malin e Zi

*Cetinë, 13 qershor 1911*

Nr. 359/128

*Lënda: Biseda me Ismail Bej Qemalin.*

Zoti Ministër,

Prej disa ditësh Ismail Bej Qemali, deputet në Parlamentin Osman, ndodhet në Cetinë. Sot erdhi të më takojë dhe më foli gjerësisht mbi problemet e vendit të tij.

Qëllimi i pranisë së tij këtu, është që të kuptojë, përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë nga ana e tij, për rolin e Malit të Zi në kryengritjen e malësorëve, dhe aspiratat që ushqejnë në lidhje me rajonin kufitar. Ai së pari shkoi te ministri i Turqisë, kurse dje u prit nga Mbreti Nikollë. Më tej ka takuar disa prej kolegëve të mi dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Malit të Zi.

Ismail Bej Qemali në fillim më shprehu se shkak i lëvizjes së tanishme revolucionare duhet kërkuar te padrejtësia, me të cilën qeveria e Kostandinopojës ka trajtuar bashkatdhetarët e tij. Ajo nuk ka marrë aspak parasysh kushtet e vështira të jetesës së tyre, ka dyshuar tek ata pa të drejtë për armiqësi ndaj regjimit të ri politik të inauguruar me rivendosjen e lirive kushtetuese, duke u mohuar atyre çdo të drejtë dhe i ka çarmatosur me anë të praktikave arbitrare, brutale dhe barbare.

Çarmatimi, i cili nisi vitin e kaluar, ka lënë tek ata një shije urrejtjeje që, duke u bashkuar me vendosjen e detyrimeve të reja për shqiptarët siç ishte pagimi i disa lloj taksave, detyrimi për shërbimin ushtarak dhe nënshtrimi ndaj ligjit, i ka shtyrë disa fise të ngrenë krye në vijim të nxitjes dhe inkurajimit nga ana e Malit të Zi.

Porse ai e dënon këtë kryengritje si të parakohshme, të pastrukturuar e të papërshtatshme, dhe ka si qëllim që të veprojë për shuarjen e saj.

Nuk pushonte së kritikuari ashpër qeverinë duke e akuzuar për paaftësi absolute, që është në duar të dyshimta dhe që rrezikonte ta çonte Perandorinë drejt shkatërrimit. Në vend që të fitonte simpatinë e shqiptarëve, të cilët gjithnjë kanë qenë një mbështetje e vyer dhe besnikë të fuqisë osmane, xhonturqit u sollën ndaj tyre në atë farë mënyre sa që i shndërruan në armiq, dhe bënë që në të gjithë Shqipërinë të ndizet një flakë që mund të shuhet vetëm me një kujdes tepër të madh dhe me një ndryshim radikal të politikës.

“Shqipëria, - vijoi Qemal Bej, - nuk dëshiron të shkëputet nga gjiri i Perandorisë Osmane, por dëshiron të ruajë identitetin e saj kombëtar, dhe ajo do të ngre gjithmonë krye pikërisht kundër tentativave të çmendura për të shkatërruar këtë identitet për ta mbrojtur atë me të gjitha forcat e saj pa dallim feje”.

Aspiratat e saj nuk janë as të paligjshme dhe as të tepërta. Ato mund të përmbliidhen në dy pika: zbatimi real i lirive të garantuara nga Kushtetuta; dhe reforma administrativo-ekonomike.

Nëse qeveria e tanishme do të jetë e zgjuar mjaftueshëm sa të kënaqë kërkesat legjitime të banorëve të një vendi që me t'u paqtuar do të bëhet

ashtu siç kanë qenë, mburojë e shtetit, çështja shqiptare nuk do të ekzistojë më.

Por, nëse në të kundërt, do të insistojë me gabimet e deritanishme, nuk do të jetë e mjaftueshme asnjë fuqi për të qetësuar Shqipërinë.

Bashkëbiseduesi im e mbylli duke më thënë se e njihte mjaft mirë Italinë, dhe se i ishin të njohura ndjenjat tona të painteresa të simpatisë ndaj vendit të tij.

Nuk m'u duk se ishte rasti që të hyja në diskutime të thella me Ismail Bej Qemalin rreth çështjeve që ai preku. I shpreha vetëm shpresën për të parë sa më shpejt rivendosjen e paqes dhe rendit në Shqipëri, gjë që është në dëshirën e të gjithë miqve të saj të singertë, mes të cilëve pa dyshim që Italia nuk zë vendin e fundit, dhe e nxita që të përdorte autoritetin e tij për mbërritjen e këtij qëllimi fisnik.

Pranoi, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

**N. SQUITTI**

*AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8138-8142*

### 23.

#### **Raport i ambasadorit italian Stamboll drejtuar ministrit të Jashtëm, mbi udhëtimin e Ismail Qemalit në drejtim të Europës dhe Italisë**

Nr. 1601/554

*Terapia, 27 qershor 1910*

*Lënda: Ismail Bej Qemali*

Zoti Ministër,

Erdhi të më takojë deputeti i njohur shqiptar Ismail Bej Qemali. Duke qenë se nuk më gjeti, bisedoi me dragomanin e parë, Comend Cangia, të cilit i tha se do të nisej sa më parë në Europë, madje, me shumë gjasa të mërkurën datë 29, për në Itali me vaporin e "Navigazione Generale". Kërkova që të lajmërohej Roma, ku ma merr mendja se do të dojë të takojë burrat tanë të shtetit, duke filluar nga Shkëlqesia Juaj; si dhe të lajmëroheshin në këtë drejtim edhe agjentët e shoqërisë "Navigazione Generale". Ai dëshiron ta mbështjellë me mister nisjen e

tij, pasi i druhet ndonjë goditjeje nga ana e armiqve të tij, dhe e ka të pamundur të saktësojë llojin e atentatit dhe se nga cila anë do t'i vijë. Sigurisht që Ismail Bej Qemali ka shumë armiq, në Komitet, në qeveri, madje edhe mes atyre që mbështesin të njëjtën kauzë. Shkëlqesia Juaj tashmë e njeh personalisht dhe me shumë gjasa e gjykon njësoj sikurse unë: njeri disi i rrezikshëm pasi është manipulator, i pavërtetë dhe me një moralitet të dyshimtë. Për çdo rast njoftova Agjencinë e Lundrimit.

Ismail Qemali natyrisht që gjykon me ashpërsi dhe me pesimizëm zhvillimin e ngjarjeve. Për Shqipërinë thotë se nuk është arritur paqtimi, pasi luftohet ende në male; edhe kur të duket se është arritur, nuk do të jetë tjetër gjë veçse e gabuar dhe e gënjeshtërt.

Pranoni, zoti ministër, ndjenjat e respektit tim të thellë.

Firma  
**MAYOR**<sup>6</sup>

AMAE në AIH, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8149-8150

#### 24.

### **Telegram i ambasadorit italian në Stamboll drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, ku e informon mbi rrezikun që i kanoset Ismail Qemalit**

Ambasada e Mbretërisë së Italisë  
në Cospoli  
Telegram nr. 2373

*Terapia, 21 korrik 1910 ora 1:50*  
*Romë, 21 korrik 1910 ora 14:35*

Nr. 269. E rezervuar.

Shoqëria sekrete u zbulua, degëzimet e saj janë më të shtrira nga sa besohej. Dje u arrestuan deputetë të rëndësishëm. Njoftoj se sipas zërave

---

<sup>6</sup> *Edmondo Mayor Des Planches* (baron) - Nga data 30 mars 1910, ambasador i Mbretërisë së Italisë në Stamboll.

që qarkullojnë, Ismail Bej Qemali duhet të jetë në Itali, edhe ai është i komprometuar.

**MAYOR**

*AMAE* në *AIH*, Fondi: Serie Politica P (1891-1916) Albania Pacco 676  
IMG 8159

